**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONERI PËR MBIKQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 1014 prot. Tiranë, më 02.12.2025

# V E N D I M

**Nr. 55, datë 02.12.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E RAPORTIT MBI VLERËSIMIN E ZBATIMIT TË LIGJSHMËRISË NË LIDHJE ME ZBATIMIN E DETYRIMIT LIGJOR, TË ORGANEVE DISIPLINORE PËR FILLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR, TË KËRKUAR NGA NJËSITË ME KOMPETENCË KONTROLLI ADMINISTRATIV NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PËR VITIN 2024.**

- Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *"Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit"*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

- Bazuar në Urdhrin nr. 110 (840 prot.), datë 12.10.2024, të Komisionerit, *"Për fillimin e mbikëqyrjes me objekt monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë në lidhje me zbatimin e detyrimit ligjor, të organeve disiplinore, për fillimin e procedimit disiplinor, të kërkuar nga njësitë me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditi, në institucionet e administratës shtetërore, për vitin 2024"*,

në përfundim të procesit të administrimit/analizimit të të dhënave të grumbulluara të materializuara në Raportin e Vlerësimit,

**V E N D O S A:**

1. Miratimin e Raportit të Vlerësimit *"Mbi vlerësimin e zbatimit të ligjshmërisë në lidhje me zbatimin e detyrimit ligjor, të organeve disiplinore për fillimin e procedimit disiplinor, të kërkuar nga njësitë me kompetencë kontrolli administrative në institucionet e administratës shtetërore, për vitin 2024"*.

2. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, www.kmshc.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**

**RAPORT**

**MBI VLERËSIMIN E ZBATIMIT TË LIGJSHMËRISË NË LIDHJE ME ZBATIMIN E DETYRIMIT LIGJOR, TË ORGANEVE DISIPLINORE PËR FILLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR, TË KËRKUAR NGA NJËSITË ME KOMPETENCË KONTROLLI ADMINISTRATIV NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE PËR VITIN 2024**

**Tiranë, Nëntor 2025**

**Baza ligjore mbi të cilën është zhvilluar procesi:**

- Ligji nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar.

- Ligji nr. 44/2015, *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"*.

- Vendimi nr. 115, datë 5.3.2014, i Këshillit të Ministrave, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil"*, ndryshuar me vendimin nr. 437, datë 18.7.2018, të Këshillit të Ministrave.

- Udhëzimi nr. 01 *(500 prot.)*, datë 21.1.2025, i Departamentit të Administratës Publike, *"Mbi organet disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore"*.

- Akte të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë aktivitetin e institucioneve të ndryshme me natyrë rregullatore, kontrolli administrative apo financiar.

## TABELA E PËRMBAJTJES:

**I. Hyrje** ........ **3**

**II. Aspekte të përgjithshme dhe statistika** ........ **6**

**III. Veprimet administrative të kryera nga organet disiplinore që nga momenti i administrimit të shkeljeve disiplinore të pretenduara nga subjektet e kontrollit deri në marrjen e vendimit për dhënie mase disiplinore ose ndërprerjen e ecurisë disiplinore.** ........ **10**

*III.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve* ........ *11*

*III.2 Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit* ........ *14*

*III.3 Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore* ........ *15*

*III.4 Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit* ........ *16*

*III.5 Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile* ........ *16*

*III.6 Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit* ........ *16*

*III.7 Agjencia Kombëtare e Mjedisit* ........ *18*

*III.8 Agjencia Kombëtare e Bregdetit* ........ *21*

*III.9 Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura* ........ *22*

*III.10Prefekti i Qarkut Fier* ........ *23*

*III.11 Prefekti i Qarkut Korçë,* ........ *24*

*III.12Prefekti i Qarkut Shkodër,* ........ *25*

**IV. Situata në lidhje me kërkesat për shkelje disiplinore të depozituara, numrin e shkeljeve të shqyrtuara nga organi disiplinor dhe si ka vendosur organi disiplinor.** ........ **26**

**V. Konkluzione:** ........ **27**

# I. Hyrje

Disiplina në shërbimin civil është një përmbledhje e rregullave, normave dhe detyrimeve ligjore që duhet të respektojë një nëpunës civil gjatë ushtrimit të funksionit të tij në sistemin e shërbimit civil dhe pasqyrohet në një prej instituteve më të rëndësishme të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, që rregullohet në kreun X *"Disiplina në shërbimin civil"*, nga nenet 57 deri 61 të tij, aplikimi i të cilit ka për qëllim funksionimin e drejtë, efikas dhe të ndershëm të administratës publike.

Disiplina në shërbimin civil, është një element i rëndësishëm nëpërmjet të cilës insitutcionet e administratës publike garantojnë shërbime sa më cilësore për qytetarët, paanësinë politike, profesionalizmin dhe integritetin institucional. Ajo nuk kufizohet vetëm në zbatimin teknik të detyrave, por përfshin edhe përkushtimin, përgjegjësinë dhe sjelljen profesionale të nëpunësit civil në çdo situatë. Nëpërmjet këtyre rregullave synohet që të orientohet çdo nëpunës që të përmbushë me përgjegjësi detyrimet e tij, të sillet me ndershmëri dhe të respektojë qytetarët si dhe hierarkinë institucionale.

Për të vendosur këtë disiplinë dhe për të reaguar në rastet kur ajo cënohet, ligji parashikon kategorinë e **masave disiplinore,** ku parashikohen sanksione të përcaktuara ligjërisht që aplikohen ndaj nëpunësve civilë kur ata kryejnë shkelje të detyrave të punës, të etikës profesionale apo të ligjit. Këto masa nuk kanë vetëm karakter ndëshkues, por edhe edukues dhe parandalues. Ato synojnë të korrigjojnë sjelljen e gabuar dhe të rivendosin rregullin institucional, duke dhënë një shembull edhe për të tjerët.

Ligji nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, përcakton qartë llojet e masave disiplinore që mund të aplikohen. Masa disiplinore duhet të jepet gjithmonë në varësi të natyrës, shkallës së shkeljes, të rrethanave në të cilat ajo ka ndodhur si dhe pasojat e ardhura prej saj duke patur në konsideratë: shkallën e fajësisë; ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashuara etj. Ato duhet të jenë gjithmonë të argumentuara, të dokumentuara dhe të vendosen pas ndjekjes së një procedure të drejtë dhe të paanshme.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në vijim të ushtrimit të kompetemcave të tij, për zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, me fokus ecurinë disiplinore që ka nisur me kërkesë të organeve me natyrë dhe tipologji kontrolli administrativ, apo dhe ato të natyrës ekonomiko-financiare, në institucionet e administratës shtetërore, me urdhrin e brendshëm nr. 110 *(840 prot.)*, datë 12.10.2024, ka filluar mbikëqyrjen e orientuar, me qëllim administrimin e të dhënave të nevojshme që pasqyrojnë situatën e zbatimit të ligjit në këtë drejtim.

Ky proces ka nisur duke vlerësuar, ndër të tjera, edhe problematikat që kanë ngritur organet me kompetenca kontrolli të brendshëm apo të jashtëm, në lidhje me respektimin e kërkesave

të tyre për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësve të konstatuar me shkelje disiplinore, gjatë veprimtarisë së tyre.

Në zbatim të objektit të mbikëqyrjes, për administrimin e të dhënave dhe qartësimin e situatës në lidhje me zbatimin e detyrimit ligjor, që kanë organet disiplinore, për fillimin e procedimit disiplinor, të kërkuar nga organe publike dhe njësi me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditi, është kërkuar informacion dhe të dhëna nga të gjitha institucionet e administratës shtetërore, që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë drejtim, për të arritur objektivin e mbikëqyrjes, janë paraqitur kërkesa të specifikuara për të dhëna në lidhje me: *a)* rastet kur organe publike apo njësi me natyrë kontrolli të brendshëm apo të jashtëm kanë depozituar në institución kërkesë/rekomandim për fillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të nëpunësve të institucionit; *b)* rastet kur organet disiplinore si eprori direkt, Komisioni Disiplinor apo dhe Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes për TND-në, kanë vendosur fillimin/mosfillimin e ecurisë disiplinore; *c)* rastet kur organi disiplinor ka vendosur ndërprerjen e ecurisë disiplinore; *d)* rastet kur organi disiplinor me vendim përfundimtar ka marrë masë disiplinore dhe lloji i masës së dhënë.

Me qëllim respektimin e parimeve të administrimit të shërbimit civil në lidhje me qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil, të parashikuar në nenin 5, të ligjit për nëpunësin civil si dhe të drejtën e informimit dhe ankimit të nëpunësit civil të parashikuar në nenin 41 të ligjit, është kërkuar informacion nëse është aplikuar e drejta e nëpunësit civil për tu ankuar në gjykatën kompetente ndaj veprimeve apo mosveprimeve që i cënojnë të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme në marrëdhënien e shërbimit civil. Në këtë drejtim është kërkuar që të evidentohen rastet konkrete dhe fazat e procesit.

Mbledhja e informacionit dhe e të dhënave të mbikëqyrjes është realizuar nëpërmjet komunikimit zyrtar me njësitë përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve civilë të çdo institucioni, përmes shkresave zyrtare. Informacioni i kërkuar nga Komisioneri, është organizuar edhe në formën e një tabele, për të unifikuar të dhënat, si edhe me qëllim që çdo subjekt të ketë mundësi që të pasqyrojë shënime apo shpjegime në lidhje me raportimet. Institucionet e varësisë kanë raportuar nëpërmjet institucioneve qendrore, nga të cilat e kanë varësinë administrative.

Më tej, për realizimin e mbikëqyrjes, nëpërmjet komunikimit zyrtar është kërkuar bashkëpunimi me organet publike dhe njësitë me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar, apo auditi, e konkretisht me:

- Kontrollin e Lartë të Shtetit,
- Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit,
- Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, si dhe,

- Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm pranë Kryeministrisë dhe çdo ministrie.

Të dhënat e administruara në lidhje me: *a)* institucionet e përfshira në mbikëqyrjen e orientuar; *b)* nëpunësit civilë ndaj të cilëve është rekomanduar fillimi i ecurisë disiplinore; *c)* organin që ka propozuar fillimin e ecurisë disiplinore dhe lloji i shkeljes së propozuar; *d)* vendimi i organit disiplinor mbi vlerësimin paraprak të shkeljes së rekomanduar; *e)* vendimi i organit disiplinor për marrjen e masës disiplinore, llojin e masës së marrë apo vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore, për të gjitha institucionet e mbikëqyrura, janë pasqyruar në *Tabelën nr. 1, "Kërkesa për shkelje disiplinore të rekomanduara nga institucione me kompetenca kontrolli të brendshëm apo të jashtëm gjatë vitit 2024. (Mbikëqyrje e realizuar në zbatim të urdhrit nr. 110 (840 prot.), dt. 12.10.2024)*. Tabela në EXCEL i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij.

## II. Aspekte të përgjithshme dhe statistika

Mbikëqyrja e orientuar ka nisur nëpërmjet urdhrit nr. 110 *(840 prot.)*, datë 12.10.2024, të Komisionerit, *"Për fillimin e mbikëqyrjes me objekt monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë në lidhje me zbatimin e detyrimit ligjor, të organeve disiplinore, për fillimin e procedimit disiplinor, të kërkuar nga njësitë me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditi, në institucionet e administratës shtetërore, për vitin 2024"*. Për realizimin e objektit të mbikëqyrjes u kërkua informacion dhe të dhëna nga **108** institucione të administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil, konkretisht nga:

- Aparati i Kryeministrisë;
- **11** Ministri;
- **84** Institucione qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrive të linjës;
- **12** Prefektura.

Situatën në lidhje me numrin e institucioneve të mbikëqyra, institucionet të cilat kanë administruar kërkesa për fillim ecurie disiplinore në ngarkim të nëpunësve të tyre dhe institucionet që nuk kanë administruar kërkesa për fillim ecurie disiplinore, për vitin 2024, e kemi paraqitur në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 1**: Situata e institucioneve të cilët kanë/nuk kanë administruar kërkesa/ rekomandime për shkelje disiplinore.

| Numri i institucioneve të mbikëqyrura | Numri i institucioneve ***që kanë*** administruar kërkesa/rekomandime për masa disiplinore | Numri i institucioneve që ***nuk kanë*** administruar kërkesa/rekomandime për masa disiplinore |
|---|---|---|
| **108** | **12** | **96** |

Nga të dhënat si më sipër rezulton se, nga **108** institucione të përfshira në *"Mbikëqyrjen e orientuar"*, vetëm **12** institucione që zënë **11%** të institucioneve të mbikëqyrura, kanë administruar kërkesa/rekomandime për fillim ecurie disiplinore në ngarkim të nëpunësve të tyre.

*Grafiku nr. 1:* *Situata në lidhje me institucionet që kanë administruar kërkesa për shkelje disiplinore*




Nga analiza dhe trajtimi i informacionit dhe të dhënave të dërguara rezulton se, Institucionet e administratës shtetërore për vitin 2024, kanë depozituar nga organet me kompetenca kontrolli të jashtëm apo të brendshëm **67** kërkesa/rekomandime për shkelje disiplinore të pretenduara se janë kryer nga nëpunës civil të institucionit.

Situatën në lidhje me numrin e rekomandimeve për shkelje disiplinore të administruara nga secili institución e kemi paraqitur në mënyrë tabelare si më poshtë:

**Tabela nr. 2:** Kërkesat/rekomandimet sipas institucionit ku janë konstatuar shkeljet disiplinore.

| Nr. | Institucionet që kanë administruar kërkesa për shkelje disiplinore | Numri i kërkesave të administruara për secilin institucion |
|---|---|---|
| 1 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (në varësi të Ministrisë së Financave) | 13 |
| 2 | Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit | 11 |
| 3 | Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit) | 2 |
| 4 | Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit | 1 |

| | | |
|---|---|---|
| | (në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes) | |
| 5 | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes) | 1 |
| 6 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit | 10 |
| 7 | Agjencia Kombëtare e Mjedisit (në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit) | 4 |
| 8 | Agjencia Kombëtare e Bregdetit (në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit) | 1 |
| 9 | Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit) | 5 |
| 10 | Administrata e Prefektit të Qarkut Fier | 6 |
| 11 | Administrata e Prefektit të Qarkut Korçë | 11 |
| 12 | Administrata e Prefektit të Qarkut Shkodër | 2 |
| **TOTAL** | | **67** |

Nga të dhënat e evidentuara në tabelë rezulton se numri më i lartë i kërkesave për shkelje disiplinore paraqitet në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (13 raste), kjo për shkak edhe të numrit të lartë të nëpunësve civilë që ka ky institucion.

Referuar subjektit të kontrollit të brendshëm apo të jashtëm që ka dërguar kërkesën /raportimin për të filluar ecurinë disiplinore në ngarkim të personave përgjejës, rezulton se:

- Në **33** raste, që zënë 49% të të gjithë kërkesave, rekomandimi fillimin e ecurisë disiplinore, është dërguar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

- Në 7 raste, që zënë 11% të të gjithë kërkesave, rekomandimi fillimin e ecurisë disiplinore, është dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

- Në 2 raste, që zënë 3% të të gjithë kërkesave, rekomandimi fillimin e ecurisë disiplinore, është dërguar nga Agjencia e Prokurimit Publik.

- Në **15** raste, që zënë 22% të të gjithë kërkesave, rekomandimi fillimin e ecurisë disiplinore, është dërguar nga Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, në Ministrinë e Financave.

- Në 9 raste, që zënë 14% të të gjithë kërkesave, rekomandimi fillimin e ecurisë disiplinore, është dërguar nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion (DIBA), në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

- Në **1** rast, që zë 1% të të të gjithë kërkesave, rekomandimi fillimin e ecurisë disiplinore, është dërguar nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor (DKT), në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

*Grafiku nr. 2: Kërkesat për shkelje disiplinore, sipas subjeketit të kontrollit të jashtëm apo të brendshëm.*




Bazuar në analizën e informacionit dhe të dhënave të dërguara rezulton se shkeljet disiplinore të pretenduara për 67 nëpunës civilë të administratës shtetërore të punësuar pranë institucioneve si më sipër, sipas rëndësisë së tyre, janë klasifikuar nga subjektet e kontrollit si më poshtë:

- Në 7 raste, që zënë 11% të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civil të pretenduar me shkelje disiplinore, janë konstatuar shkelje *shumë të rënda*, të parashikauara në pikën 2, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar.

- Në 29 raste, që zënë 44% të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civil të pretenduar me shkelje disiplinore, janë konstatuar *shkelje të rënda*, të parashikauara në pikën 3, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar.

- Në 30 raste, që zënë 45% të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civil të pretenduar me shkelje disiplinore, janë konstatuar *shkelje të lehta*, të parashikauara në pikën 4, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar.

Shkeljet e pretenduara nga subjektet e kontrollit, të klasifikuara sipas llojit të tyre, paraqiten në mënyrë grafike si më poshtë:

*Grafiku nr. 3: <u>Situata e shkeljeve të pretenduara/konstatuara sipas llojit të shkeljes.</u>*




Nga analiza e gjithë të dhënave të pasqyruara si më sipër, është konstatuar se nga subjektet e kontrollit të jashtëm apo të brendshëm, gjatë vitit 2024, është pretenduar se **<u>67</u>** nëpunës civilë kanë lejuar shkelje të disiplinës në shërbimin civil. Në të gjitha rastet, kërkesa apo rekomandimi për fillim e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit përgjegjës është depozituar në institucionin e administratës shtetërore ku nëpunësi është i punësuar.

## III. Veprimet administrative të kryera nga organet disiplinore që nisin nga momenti i administrimit të shkeljeve disiplinore të pretenduara nga subjektet e kontrollit, deri në finalizimin e procesit me një vendim për dhënie mase disiplinore ose ndërprerjen e ecurisë disiplinore.

Mbikëqyrja e orientuar e zhvilluar në këtë rast, ka përfshirë të gjitha institucionet e administratës shtetërore, për të arrritur në konkluzionin se si veprojnë organet disiplinore gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, për rastet kur subjekte kontrolli, të përcaktuara në mënyrë specifike në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, kërkojnë fillimin e ecurisë disiplinore për një nëpunës civil.

Në këtë rast, ligji për nëpunësin civil, ka parashikuar si detyrim, zhvillimin e një tërësie veprimesh procedurale, të cilat duhet të zbatohen sipas rendit të përcaktuar në kreun X, titulluar *"Disiplina në shërbimin civil"*, të ligjit në fjalë. Po kështu, këto detyrime ligjore, janë specifikuar edhe në vendimin nr. 115, datë 5.3.2015 të Këshillit të Ministrave, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil"*, i ndryshuar me vendimin nr. 437, datë 18.7.2018, të Këshillit të Ministrave, si edhe në udhëzimin nr. 01 *(500 prot.)*, datë

21.1.2025, i Departamentit të Administratës Publike, *"Mbi organet disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore"*.

Ashtu si e kemi përmendur edhe më sipër në këtë material, institucionet e administratës shtetërore për vitin 2024, kanë depozituar nga organet me kompetenca kontrolli të jashtëm apo të brendshëm **67** kërkesa/rekomandime për shkelje disiplinore të pretenduara se janë kryer nga nëpunës civil të institucionit. Nga **108** institucione të mbikëqyrura, vetëm **12** prej tyre kanë administruar kërkesa/rekomandime për shkelje disiplinore, ashtu si është evidentuar në tabelën nr.2, *"Institucionet që kanë administruar kërkesa për shkelje disiplinore gjatë vitit 2024"*, të kreut II, të këtij raporti.

Duke vlerësuar veprimet administrative që janë kryer, nga momenti i administrimit të shkeljes disiplinore nga institucioni ku punon nëpunësi ndaj të cilit është pretenduar shkelja disiplinore, e deri në marrjen e vendimit përfundimtar për finalizimin e ecurisë disiplinore, nga organi disiplinor, ***për secilin institucion është konstatuar si më poshtë***:

### *III.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve*
### *(në varësi të Ministrisë së Financave)*

Bazuar në informacionin dhe të dhënat e dërguara nga Ministria e Financave është konstatuar se nga **8** institucione pjesë e shërbimit civil që ka sistemi i kësaj ministrie *(aparati i ministrisë dhe 7 institucione të varësisë)*, vetëm *Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve* ka administruar rekomandime për shkelje disiplinore të dërguara nga subjekte me kompetenca kontrolli të jashtëm apo të brendshëm, për **13** nëpunës civilë, të punësuar pranë këtij institucioni. Nga informacioni dhe të dhënat e administruara rezulton se:

- Në **3** raste, rekomandimi për shkelje disiplinore është dërguar nga *Kontrolli i Lartë i Shtetit*, bëhet fjalë për nëpunësit:

  - *Gjergji Duro*, në pozicionin Përgjegjës Sektori,
  - *Artan Pasholli*, në pozicionin Drejtor Rajonal,
  - *Elmira Elmazaj*, në pozicionin Përgjegjës Sektori.

Në rastin e nëpunësve *Gjergji Duro* dhe *Artan Pasholli*, institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka rekomanduar/propozuar fillimin e ecurisë disiplinore për *"Shkelje shumë të rëndë"*, ndërsa për nëpunësen *Elmira Elmazaj*, ka rekomanduar/propozuar fillimin e ecurisë disiplinore për *"Shkelje të rëndë"*.

- Në **9** raste, rekomandimi për shkelje disiplinore është dërguar nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion (DIBA), në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kjo njësi strukturore është pjesë e strukturës dhe organikës së institucionit me kompetenca kontrolli dhe hetimi administrativ. Konkretisht, bëhet fjalë për nëpunësit:

- *Dalina Teferiçi*, në pozicionin Drejtor Rajonal,
- *Dritan Xhija*, në pozicionin Përgjegjës Sektori,
- *Dorjan Deçolli*, në pozicionin Inspektor Kontrolli,
- *Apostol Duka*, në pozicionin Inspektor Kontrolli,
- *Dritan Milori*, në pozicionin Përgjegjës Sektori,
- *Ervis Kapo*, në pozicionin Inspektor i dytë Borxhi,
- *Mario Zyla*, në pozicionin Inspektor i dytë Borxhi,
- *Eris Rezhda*, në pozicionin Inspektor i dytë Borxhi,
- *Xhevahir Toçilla*, në pozicionin Përgjegjës Sektori.

Konstatohet se:

Në rastin e nëpunësve *Dalina Teferiçi*, *Dritan Xhija*, *Dorjan Deçolli*, *Apostol Duka*, Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion (DIBA), në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve *(që në këtë rast është njësi strukturore e institucionit me kompetenca kontrolli dhe hetimi administrativ)* ka rekomanduar/propozuar fillimin e ecurisë disiplinore për *"Shkelje të rëndë"*.

Në rastin e nëpunësve *Dritan Milori*, *Ervis Kapo*, *Mario Zyla*, *Eris Rezhda*, *Xhevahir Toçilla*, Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion (DIBA), ka rekomanduar/propozuar fillimin e ecurisë disiplinore për *"Shkelje shumë të rëndë"*.

- Në **1** rast, rekomandimi për shkelje disiplinore është dërguar nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kjo njësi strukturore është pjesë e strukturës dhe organikës së institucionit me kompetenca kontrolli dhe hetimi administrativ. Konkretisht, bëhet fjalë për nëpunësin *Altin Haxhi*, në pozicionin Inspektor i Parë Kontrolli. Për këtë nëpunës civil, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ka rekomanduar/propozuar fillimin e ecurisë disiplinore për *"Shkelje shumë të rëndë"*.

Organet disiplinore të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pasi janë vënë në dijeni të pretendimeve për shkelje disiplinore për rastet e evidentuara si më sipër, kanë vepruar në përputhje me rregullat e parashikuara në pikën 11, të kreut II, të VKM nr. 115, datë 5.3.2015 të Këshillit të Ministrave *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil"*, ku parashikohet në mënyrë të shprehur se: *"Në rast se eprori direkt vihet në dijeni për një shkelje disiplinore nga subjektet e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013, eprori direkt fillon menjëherë ecurinë disiplinore, ose nëse nuk është kompetent për shqyrtimin e saj, ia përcjell informacionin KD"*.

Në të gjitha rastet, eprori direkt pasi ka marrë dijeni për informacionin e depozituar në institucion dhe për shkeljen disiplinore të pretenduar për punonjësit përkatës, ka vlerësuar rëndësinë e shkeljes dhe organin që do të zhvillonte ecurinë disiplinore. Më pas,

kërkesa/rekomandimi për shkelje displinore të rëndë apo shkelje disiplinore shumë të rëndë disiplinore i është dërguar zyrtarisht Komisionit Disiplinor të Drejtorisë së Përgjithsdhme të Tatimeve.

Komisioni Disiplinor në të gjitha rastet e marrjes dijeni për shkelje disiplinore (**13** raste), ka realizuar tërësinë e procedurave të përcaktuara në pikat nga 13 deri 20 të VKM nr. 115, dt. 5.3.2014, i ndryshuar, dhe në përfundim të shqyrtimit, ka vendosur:

- Vendim nr. 47, datë 7.2.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *"Mbajtja e 1/3 së pagës për një periudhë 6-mujore"*, për nëpunësen Dalina Teferiçi.
- Vendim nr. 48, datë 7.2.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *"Largim nga shërbimi civil"*, për nëpunësin Dritan Xhija.
- Vendim nr. 49, datë 7.2.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *"Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1-vjeçare"*, për nëpunësin Dorjan Deçolli.
- Vendim nr. 50, datë 7.2.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *"Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1-vjeçare"*, për nëpunësin Apostol Duka.
- Vendim nr. 231, datë 23.5.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *"Largim nga shërbimi civil"*, për nëpunësin Dritan Milori.
- Vendim nr. 230, datë 23.5.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *"Largim nga shërbimi civil*, për nëpunësin Ervis Kapo.
- Vendim nr. 229, datë 23.5.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *"Largim nga shërbimi civil"*, për nëpunësin Mario Zyla.
- Vendim nr. 228, datë 23.5.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *"Largim nga shërbimi civil"*, për nëpunësin Eris Rezhda.
- Vendim nr. 341, dt. 22.8.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *"Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy muaj"*, për nëpunësin Xhevahir Toçilla.
- Vendim nr. 159, datë 4.4.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *"Largim nga shërbimi civil"*, për nëpunësin Altin Haxhi.
- Vendim nr. 129, datë 13.3.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore "Largim nga shërbimi civil", për nëpunësin Gjergji Duro.
- Vendim nr. 430, datë 4.11.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *"Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj"*, për nëpunësen Elmira Elmazaj.
- Vendim nr. 417, datë 29.10.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *"Largim nga shërbimi civil"*, për nëpunësen Artan Pasholli.

Bazuar në faktet dhe të dhënat e përmendura më sipër, konstatohet se organet disiplinore të Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve, *(institucion në varësi të Ministrisë së Financave),* gjatë vitit 2024, në të gjitha rastet **i kanë zhvilluar** të gjitha veprimet administrative që nisin nga

momenti i depozitimit të kërkesës/raportimit të shkeljes së pretenduar nga subjekte me kompetenca kontrolli të jashtëm apo të brenshëm, të përcaktuara në shkronjën *"b"*, pika 4, të nenit 59, të ligjit për nëpunësin civil.

### *III.2 Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit*

Nga trajtimi dhe përpunimi i informacionit dhe të dhënave të dërguara nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është konstatuar se nga **10** institucione pjesë e shërbimit civil që ka sistemi i kësaj ministrie (*Aparati i ministrisë dhe 9 institucione të varësisë)*, kanë administruar rekomandime për shkelje disiplinore të dërguara nga subjekte me kompetenca kontrolli të jashtëm vetëm 2 prej tyre, konkretisht, Aparati i ministrisë **11** kërkesa dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (*institucion varësie)* **2** kërkesa.

Nga informacioni dhe të dhënat e administruara për ***Aparatin e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit***, është konstatuar se:

- Në **11** raste, rekomandimi për shkelje disiplinore është dërguar nga *Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, në Ministrinë e Financave* dhe bëhet fjalë për nëpunësit:

- *Vjollca Dega*, në pozicionin Specialist,
- *Eranda Bedalli*, në pozicionin Specialist,
- *Eraldo Muskaj*, në pozicionin Përgjegjës Sektori,
- *Albjona Ocelli*, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë,
- *Fabiola Islami*, në pozicionin Specialist,
- *Irena Prici*, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë,
- *Arjola Sako*, në pozicionin Përgjegjës Sektori,
- *Armando Alushi*, në pozicionin Specialist,
- *Eriola Jeniceri*, në pozicionin Përgjegjës Sektori,
- *Klodilda Spahiu*, në pozicionin Specialist,
- *Entela Çipa*, në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm.

Konstatohet se, për të gjithë nëpunësit e evidentuar më sipër, *Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, në Ministrinë e Financave*, që në këtë rast është njësi strukturore e institucionit me kompetenca kontrolli dhe hetimi administrativ, ka rekomanduar/propozuar fillimin e ecurisë disiplinore për kategorinë: *"Shkelje e lehtë"*.

Konstatohet se eprori dirket i çdo nëpunësi të cilit i atribuohet shkelja disiplinore e pretenduar, ka realizuar tërësinë e procedurave të përcaktuara në pikat nga 11 deri në 18, të VKM nr. 115, dt. 5.3.2014, i ndryshuar, dhe në përfundim në *10 raste*, bazuar në përcaktimet e kreut II, pika 17 dhe 18, të këtij akti nënligjor, është vendosur ndërprerja e ecurisë disiplinore. Ndërsa në një rast, konkretisht për nëpunësen *Entela Çipa*, procedurat administrative për dhënie mase disiplinore janë në proces.

Bazuar në faktet si më sipër, konstatohet se organet disiplinore të Aparatit të Ministrsë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, gjatë vitit 2024, në 10 raste, **i kanë zhvilluar** të gjitha veprimet administrative që nisin nga momenti i depozitimit të kërkesës/raportimit të shkeljes së pretenduar nga subjekte me kompetenca kontrolli të jashtëm apo të brenshëm të përcaktuara në shkronjën *"b"*, pika 4, të nenit 59, të ligjit për nëpunësin civil, ndërsa **në 1 rast, procedurat administrative për dhënie mase disiplinore janë në proces.**

### *III.3 Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore*
*(në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit).*

Ky institucion gjatë vitit 2024, ka administruar **2** kërkesa/rekomandime për shkelje të rënda, të dërguara nga *Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, në Ministrinë e Financave*, që në këtë rast është njësi strukturore e Ministrisë së Financave me kompetenca kontrolli dhe hetimi administrativ.

Në këtë rast, është pretenduar se shkeljet disiplinore janë kryer nga nëpunësit:

1) *Solora Lilo*, në pozicionin Inspektor,
2) *Andri Rugji*, në pozicionin Inspektor.

Konstatohet se, në kërkesën/rekomandimin e administruar për fillim ecurie disiplinore ndaj nëpunësve në fjalë është pretenduar shkelje e rëndë e disiplinës në shërbimin civil. Komisioni Disiplinor pas marrjes dijeni për shkelje disiplinore, ka realizuar tërësinë e procedurave të përcaktuara në pikat nga 13 deri 20, të VKM nr. 115, dt. 5.3.2014, i ndryshuar, dhe në përfundim të shqyrtimit, ka vendosur, nëpërmjet akteve administrative:

1) Vendimi nr. 904/13, datë 13.6.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *"Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës së pagës për një periudhë 3 mujore"*, për nëpunësen *Solora Lilo*.
2) Vendimi nr. 904/14, datë 13.6.2024, i Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *"Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës së pagës për një periudhë 3 mujore"*, për nëpunësen *Andri Rugji*.

Në të dy rastet, vendimi për marrje mase disiplinore nuk është ankimuar nga nëpunësit.

Sa më sipër, konstatohet se Komisioni Disiplinor i *Inspektoratit Shteteror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore*, gjatë vitit 2024, **i kanë zhvilluar** të gjitha veprimet administrative që kryhen nga momenti i depozitimit të kërkesës/raportimit të shkeljes së pretenduar nga subjekte me kompetenca kontrolli të jashtëm apo të brendshëm të përcaktuara në shkronjën *"b"*, pika 4, të nenit 59, të ligjit për nëpunësin civil.

### *III.4 Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit*
*(në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes)*

Ky institucion gjatë vitit 2024, ka administruar **1** kërkesë/rekomandim për shkelje të rëndë, të dërguar nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Në këtë rast, është pretenduar se shkelja disiplinore është kryer nga nëpunësi *Algert Saraseli*, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë.

Komisioni Disiplinor pas marrjes dijeni për shkelje disiplinore, **ka realizuar** tërësinë e procedurave të përcaktuara në pikat nga 13 deri 20 të VKM nr. 115, dt. 5.3.2014, i ndryshuar, dhe në përfundim të shqyrtimit, me vendimin nr. 25, datë 16.12.2024, ka dhënë mësën disiplinoire: *"Mbajtja e 1/5 e pagës së plotë për një periudhë 1-mujore"*. Vendimi për marrje mase disiplinore nuk është ankimuar në gjykatë.

### *III.5 Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile*
*(në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes)*

Ky institucion gjatë vitit 2024, ka administruar **1** kërkesë/rekomandim për shkelje të lehtë, të dërguar nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Në këtë rast, është pretenduar se shkelja disiplinore është kryer nga nëpunësja *Edona Parangoni*, në pozicionin e specialistit.

Eprori dirket i nëpunësit të cilit i atribuohet shkelja disiplinore e pretenduar, **ka realizuar** tërësinë e procedurave të përcaktuara në pikat nga 11 deri në 18/a, të VKM nr. 115, dt. 5.3.2014, i ndryshuar, dhe në përfundim me vendimin nr. 160/3 prot., datë 1.10.2024 ka vendosur ndërprerje e ecurisë disiplinore, me arsyetimin se nuk evidentohet shkelje e disiplinës në shërbimin civil.

### *III.6 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit*

Bazuar në informacionin dhe të dhënat e dërguara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është konstatuar se gjatë vitit 2024, ky institucion ka administruar kërkesa/rekomandime për shkelje disiplinore të dërguara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për **10** nëpunës. Konkretisht, është pretenduar se kanë kryer shkelje të lehta disiplinore nëpunësit:

1) *Trajan Vasili*, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar;
2) *Inxhi Buzi*, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve;
3) *Rudina Luka*, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve dhe Parneriteteve;
4) *Anjutinka Sullaj*, në pozicionin Specialist i Sektorit të Prokurimeve;

5) *Shefqet Kamberi*, në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme;
6) *Anisa Musta*, në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit;
7) *Sonila Pashaj*, në pozicionin Specialist në Sektorin e Planifikimit & Kordinimit të Programeve në Mjedis;
8) *Elton Orozi*, në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Projekteve Zhvillimore;
9) *Alma Baze*, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Turizmit;
10) *Shpresa Harasani*, në pozicionin Specialist i Ndryshimeve Klimatike.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se eprori dirket i çdo nëpunësi të cilit i atribuohet shkelja disiplinore e pretenduar, pasi është vënë në dijeni për shkeljen disiplinore të kërkuar/rekomandur nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka vlerësuar se konstatimet nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për nisje të ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit përkatës. *(Shkresat e dërguara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me nr. 4837 prot., datë 22.7.2024; nr. 4839 prot., dt. 22.7.2024; nr. 4903 prot., dt. 25.7.2024; nr. 4904 prot., dt. 25.7.2024 dhe nr. 4902 prot., dt. 25.7.2024).*

Vihet re se, në përmbajtjen e shkresave për mosfillim ecurie disiplinore nuk është përmendur baza ligjore ku është mbështetur eprori direkt i cili ka vlerësuar të mos fillojë ecurinë disiplinore për nëpunësin përkatës.

Në rastin konkret, duhet të theksojmë faktin se eprori direkt është vënë në dijeni për shkelje disiplinore nga institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është organi më i lartë publik i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë dhe si i tllë ai përfshihet në *subjektet e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 4, të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013.*

Për këtë arsye, në rastin e nëpunësve si më sipër, organi disiplinor duhet të vepronte në përputhje me përcaktimet e pikës 11, të kreut II, të vendimit nr. 115, datë 5.3.2015, të Këshillit të Ministrave *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil"*, ku parashikohet në mënyrë të shprehur se: *"Në rast se eprori direkt vihet në dijeni për një shkelje disiplinore nga subjektet e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, eprori direkt fillon menjëherë ecurinë disiplinore, ose nëse nuk është kompetent për shqyrtimin e saj, ia përcjell informacionin KD".*

Pra, vendimi nr. 115, datë 5.3.2015, i Këshillit të Ministrave, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil"*, përcakton se për shkelje disiplinore të kërkuara/rekomandura nga organe me kompetenca kontrolli të jashtme ose të brendshme, organi disiplinor fillon menjëherë ecurinë disiplinore dhe më tej zbaton tërësinë e procedurave administrative disiplionore të parashikuara nga pika 13 deri në 20, të këtij akti nënligjor, **ç`ka nuk është respektuar nga organet e disiplinës në këtë rast.**

Nga sa u analizuar për këtë rast, konstatohet se nga ana e organeve të disiplinës në këtë institucion **nuk janë zbatuar** përcaktimet e akteve ligjore në fuqi dhe për të rregulluar ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, duhet të kryhen këto veprime:

- Eprori direkt, të fillojë ecurinë disiplinore dhe të kryej të gjithë procedurën ligjore, me qëllim që të arrijë në konkluzione të qarta për finalizimin e saj.

### *III.7 Agjencia Kombëtare e Mjedisit*
*(në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit)*

Bazuar në informacionin dhe të dhënat e dërguara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, është konstatuar se subjekte me kompetenca kontrolli të jashtëm apo të brendshëm kanë depozituar pranë këtij institucioni kërkesa/rekomandime për shkelje disiplinore në ngarkim të 4 (katër) nëpunësve civilë. Rezulton se:

✓ Në 2 raste, rekomandimi për shkelje disiplinore është dërguar nga Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, në Ministrinë e Financave, që është njësi strukturore e Ministrisë së Financave me kompetenca kontrolli dhe hetimi administrativ.

Më konkretisht, është pretenduar se kanë kryer *"Shkelje të lehtë"* disiplinore nëpunësit:

1) *Enver Halipaj*, me detyrë Inspektor në Sektorin e Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, në Drejtorinë e Inspektimit Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit;

2) *Ilinden Maze*, me detyrë *"Përgjegjës Sektori"*, në Sektorin e Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë Gjirokastër.

Eprori dirket i nëpunësit të cilit i atribuohet shkelja disiplinore e pretenduar, ka realizuar tërësinë e procedurave të përcaktuara në pikat nga 11 deri në 18, të *vendimit* nr. 115, datë 5.3.2015, të Këshillit të Ministrave *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil"*, i ndryshuar, dhe i ka finalizuar ato nëpërmjet akteve administrative përkatëse:

- Vendimi nr. 1, datë 13.12.2024, i eprorit direkt, *"Për ndërprerjen e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit civil Enver Halipaj"*. Më pas, me shkresën nr. 13039/1 prot., datë 13.12.2024, vendimi për ndërprerje të ecurisë disiplinore i është dërguar për dijeni njësisë përgjegjëse DAP.

- Vendimi nr. 2 datë 19.12.2024, i eprorit direkt, *"Për ndërprerjen e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit civil Iliden Maze"*. Më pas, me shkresën nr. 13398/1 prot., datë 13.12.2024, vendimi për ndërprerje të ecurisë disiplinore i është dërguar për dijeni njësisë përgjegjëse DAP.

Bazuar në faktet si më sipër, konstatohet se në rastin e shkeljeve disiplinore të pretenduara për nëpunësit *Enver Halipaj* dhe *Iliden Maze*, organi disiplinor që në këtë rast është eprori direkt i nëpunësit të cilit i atribuohet shkelja disiplinore, i ka zhvilluar të gjitha veprimet administrative të përcaktuara në pikat nga 11 deri 20 të VKM nr. 115, dt. 5.3.2014, i ndryshuar.

- Në **2** raste, kërkesa/rekomandimi për shkelje disiplinore të pretenduar është konstatuar nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion nëpërmjet Raportit Përfundimtar me nr. R-90 Prot., datë 29.3.2023. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, si struktura e dedikuar për çështjet antikorrupsion ka kompetenca të kontrollit dhe hetimit administrativ.

Më konkretisht, është pretenduar se kanë kryer *"Shkelje të lehtë"* disiplinore nëpunësit:

1) *Neritan Postoli*, me detyrë *"Drejtor"*, pranë Drejtorisë së Kërkimit dhe Dijes Mjedisore në AKM.
2) *Vanela Gjeci*, me detyrë *"Përgjegjës Sektori"*, në Sektorin e Laboratorëve pranë Drejtorisë së Kërkimit dhe Dijes Mjedisore në AKM.

Ne analizë të dokumentacionit të administruar rezulton se këta punonjës nëpërmjet shkresës nr. 2564/1 prot., datë 3.4.2023, *"Memo, kthim përgjigje shkresës me Nr. R-90, datë 29.03.2023"*, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së, kanë sqaruar dhe argumentuar se nga ana e tyre nuk janë kryer veprime apo mosveprime që të mund të klasifikohen si shkelje disiplinore.

Eprori direkt pasi është njohur me sqarimet e dërguara nga nëpunësit, bazuar në pikën 8, të kreut II, të VKM nr. 115, dt. 5.3.2014, ka vlerësuar se në përmbajtjen e Raportit Nr. R-90, datë 29.3.2023, *"nuk ka elemente që mund të klasifikohen si shkelje disiplinore, për të vijuar me ngritjen e Komisionit Disiplinor, pasi rezulton se punonjësit nuk kanë kryer shkelje faktike"*. Më pas, vlerësimi i bërë në lidhje me shkeljet disiplinore të pretenduara i është njoftuar Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit me shkresën nr. 12017, prot., datë 18.11.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së

Bazuar në përcaktimet e shkronjës *"b"*, pika 4, të nenit 59, të ligjit për nëpunësin civil, *"Komisioni disiplinor fillon procedimin me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil"*.

Në mbështetje të kësaj dispozite ka dalë vendimi nr. 115, datë 5.3.2014, i Këshillit të Ministrave, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*. Në ndryshimet që i janë bërë këtij akti nënligjor me VKM nr. 437, dt. 18.7.2018, *"Për disa shtesa në vendimin nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të*

*rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*, janë përcaktuar në mënyrë të shprehur veprimet administrative që duhet të kryhen në rastet kur shkeljet disiplinore të pretenduara janë konstatuar nga *Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, si dhe Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion.* Më konkretisht, ndryshimet e bëra në VKM nr. 115, dt. 5.3.2015, parashikojnë si më poshtë:

*(Pika 6/1)* *"Përjashtimisht për rastet kur shkeljet disiplinore të pretenduara janë konstatuar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje si dhe Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion, kërkesa/rekomandimi i depozituar në institucion, sipas pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi, i dërgohet komisionit disiplinor".*

*(Pika 7/1)* *"Komisioni disiplinor, në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, sipas pikës 6/1, të kreut II, të këtij vendimi, e vlerëson paraprakisht atë. Nëse nga vlerësimi i informacionit të marrë nuk rezulton të ketë elemente që mund të klasifikohen si shkelje disiplinore, komisioni disiplinor vendos të mos fillojë ecurinë disiplinore".*

*(Pika 9/1)* *"Në rast se nga informacioni i marrë, sipas pikës 6/1, të kreut II, të këtij vendimi, rezulton të ketë elementë të klasifikuara si shkelje disiplinore, komisioni disiplinor bën klasifikimin e shkeljeve sipas pikës 1, të nenit 57, të ligjit 152/2013, të ndryshuar. Në rast se nga vlerësimi rezulton se:*
*a) shkelja klasifikohet në shkeljet e rënda apo shumë të rënda, komisioni disiplinor fillon ecurinë disiplinore;*
*b) shkelja klasifikohet në shkeljet e lehta, komisioni disiplinor i kërkon eprorit direkt të fillojë ecurinë disiplinore".*

Referuar dispozitave të cituara si më sipër, për nëpunësit *Neritan Postoli* dhe *Vanela Gjeci*, kërkesa/rekomandimi për shkelje disiplinore e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion duhet t'i dërgohej Komisionit Disiplinor të institucionit, i cili kishte detyrimin për zbatimin e tërësisë së procedurave të përcaktuara në pikat 7/1 e 9/1 të VKM nr. 115, datë 5.3.2014, i ndryshuar, **ç`ka nuk është respektuar nga organet e disiplinës në këtë rast.**

**Konkluzion:**

Nga sa u analizuar për këtë rast, konstatohet se nga ana e organeve të disiplinës në këtë institucion **nuk janë zbatuar** përcaktimet e akteve ligjore në fuqi dhe për të rregulluar ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, duhet të kryhen këto veprime:

- Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të marrë masat e duhura për realizimin e procedurës disiplinore për nëpunësit në fjalë, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe aktit nënligjor që rregullon këtë institut, duke u kujdesur që të ngrihet Komisioni i Disiplinës, sipas parashikimeve ligjore.

- Organet e disiplinës, që në këtë rast është Komisioni i Disiplinës dhe eprori direkt, nëse Komisioni i Disiplinës vlerëson se shkelja e disiplinës klasifikohet në shkeljet e lehta, të materializojnë me akte administrative çdo veprim të kryer, në çdo fazë të këtij procesi në përputhje me kreun II, pika 6/1, të VKM-së nr. 437, dt. 18.7.2018, *"Për disa shtesa në vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*.

### *III.8 Agjencia Kombëtare e Bregdetit*
*(në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit)*

Ky institucion gjatë vitit 2024, ka administruar 1 *(një)* kërkesë/rekomandim për shkelje të rëndë, të dërguar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Në këtë rast, është pretenduar se shkelja disiplinore është kryer nga nëpunësja *Enxhi Dibra*, në pozicionin Specialist në Sektorin Juridik dhe Ankimeve Administrative.

Organi disiplinor, në këtë rast Komisioni i Disiplinës, pasi është vënë në dijeni për shkeljen disiplinore, ka vlerësuar se shkelja që i atribuohet nëpunësit nuk është klasifikuar drejtë dhe për këtë arsye me aktin nr. 116, datë 12.6.2024, *"Vendim i ndërmjetëm"*, ka vendosur moskompetencë për fillimin e ecurisë disiplinore të propozuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe dërgimin për veprim eprorit direkt.

Eprori direkt i nëpunësit me vendimin nr. 117, datë 19.6.2024, ka vendosur mosfillimin e ecurisë disiplinore për nëpunësen *Enxhi Dibra*.

Nënvizojmë se në rastin konkret, eprori direkt është vënë në dijeni për shkelje disiplinore nga institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është organi më i lartë publik i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë dhe si i tllë ai përfshihet në subjektet i përcaktuara në shkronjën *"b"*, të pikës 4, të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013. Për këtë arsye, në rastin e nëpunësve si më sipër organi disiplinor duhet të vepronte në përputhje me përcaktimet e pikës 11, të kreut II, vendimit nr. 115, datë 5.3.2015, të Këshillit të Ministrave *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil"*, ku parashikohet në mënyrë të shprehur se: *"Në rast se eprori direkt vihet në dijeni për një shkelje disiplinore nga subjektet e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, eprori direkt fillon menjëherë ecurinë disiplinore, ose nëse nuk është kompetent për shqyrtimin e saj, ia përcjell informacionin KD"*.

Pra, vendimi nr. 115, datë 5.3.2015, i Këshillit të Ministrave, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil"*, përcakton se për shkelje disiplinore të kërkuara/rekomandura nga organe me kompetenca kontrolli të jashtme ose të brendshme, organi disiplinor fillon menjëherë

ecurinë disiplinore dhe më tej zbaton tërësinë e procedurave administrative disiplinore të parashikuara nga pika 13 deri në 20, të këtij akti nënligjor, **ç`ka nuk është respektuar nga organet e disiplinës në këtë rast.**

Nga sa u analizuar për këtë rast, konstatohet se nga ana e organeve të disiplinës në këtë institucion **nuk janë zbatuar** përcaktimet e akteve ligjore në fuqi dhe për të rregulluar ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, duhet të kryhen këto veprime:

- Eprori direkt, të fillojë ecurinë disiplinore dhe të kryej të gjithë procedurën ligjore, me qëllim që të arrijë në konkluzione të qarta për finalizimin e saj.

### *III.9 Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura*
*(në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit)*

Bazuar në informacionin dhe të dhënat e dërguara nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, është konstatuar se ky institucion ka administruar rekomandime për shkelje disiplinore të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion për **5** nëpunës civilë. Në këtë rast, janë pretenduar *"shkelje të rënda"* të disiplinës për **3** nëpunës dhe *"shkelje të lehta"* disiplinore për **2** nëpunës.

Më konkretisht është pretenduar se kanë kryer *"Shkelje të rënda"*, nëpunësit:

1) *Durim Selmani*, në pozicionin *"Përgjegjës i Sektorit të e Monitorimit"*, trasferuar në AKP;
2) *Kasem Uzuni*, në pozicionin *"Specialist në Sektorin e Monitorimit"*;
3) *Merita Çeka*, në pozicionin *"Specialist në Sektorin e Monitorimit"*.

Ndërsa, është pretenduar se kanë kryer *"Shkelje të lehta"*, nëpunësit:

1) *Sulejman Xhepa*, në pozicionin *"Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit AKZM"*,
2) *Grisela Canollari*, në pozicionin *"Specialist në Sektorin e Monitorimit"*.

Konstatohet se, Komisioni Disiplinor pas marrjes dijeni për shkeljet disiplinore, të pretenduara për nëpunësit *Durim Selmani*, *Kasem Uzuni* dhe *Merita Çeka*, ka realizuar tërësinë e procedurave të përcaktuara në pikat 6/1, 7/1 e 9/1, të VKM nr. 115, datë 5.3.2014, i ndryshuar dhe ka finalizuar procesin sipas akteve administrative:

- Vendimi nr. 101, datë 21.3.2023, i Komisionit Disiplinor *"Ndërprerje e ecurisë disiplinore për nëpunësin civil Durim Selmani, Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Monitorimit, në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura"*;

- Vendimi nr. 102, datë 21.3.2023, i Komisionit Disiplinor *"Ndërprerje e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit civil Kasem Uzuni, Specialist, në Sektorin e Monitorimit".*

- Vendimi 103 datë 21.3.2023, *"Ndërprerjen e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit civil Merita Çeka Specialist, në Sektorin e Monitorimit".*

Ndërsa për nëpunësit *Sulejman Xhepa*, në pozicionin *"Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit AKZM"* dhe *Grisela Canollari*, në pozicionin *"Specialist në Sektorin e Monitorimit"*, **nuk është marrë asnjë masë** për trajtimin e rekomandimeve të lëna nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion e cila është strukturë e dedikuar për çështjet antikorrupsion me kompetenca të kontrollit dhe hetimit administrativ.

Referuar fakteve të përmendura më sipër, për nëpunësit *Sulejman Xhepa*, dhe *Grisela Canollari*, ndaj të cilëve është pretenduar se kanë kryer shkelje të lehtë disiplinore, të konstatuar nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, duhet të zbatohen tërësia e procedurave të përcaktuara në pikat 6/1, 7/1 e 9/1 të VKM nr. 115, datë 5.3.2014, i ndryshuar.

Konkluzion:

Nga sa u analizuar për këtë rast, konstatohet se nga ana e organeve të disiplinës në këtë institucion **nuk janë zbatuar** përcaktimet e akteve ligjore në fuqi dhe për të rregulluar ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, duhet të kryhen këto veprime:

- Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të marrë masat e duhura për realizimin e procedurës disiplinore për nëpunësit në fjalë, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe aktit nënligjor që rregullon këtë institut, duke u kujdesur që të ngrihet Komisioni i Disiplinës, sipas parashikimeve ligjore.
- Organet e disiplinës, që në këtë rast është Komisioni i Disiplinës dhe eprori direkt, nëse Komisioni i Disiplinës vlerëson se shkelja e disiplinës klasifikohet në shkeljet e lehta, të materializojnë me akte administrative çdo veprim të kryer, në çdo fazë të këtij procesi në përputhje me kreun II, pika 6/1 të VKM-së nr. 437, dt. 18.07.2018 *"Për disa shtesa në vendimin nr. 115,* datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil".*

### ***III.10 Prefekti i Qarkut Fier***
*(në varësi të Ministrisë së Brendshme)*

Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se, për **6** nëpunës të Prefektit të Qarkut Fier, institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka propozuar/rekomanduar masë disiplinore për "*shkelje të rëndë*".

Organi disiplinor, në këtë rast Komisioni Disiplinor, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkeljes së pretenduar, ka vendosur ndërprerjen e procedimit disiplinor për nëpunësit:

1) *Arben Velo*, në pozicionin *"Sekretar i Përgjithshëm"*, *(vendim nr. 1068/20, dt.21.11.2024, i Komisionit Disiplinor)*;
2) *Alma Gjonaj*, në pozicionin *"Përgjegjës i Sektorit Juridik"*, *(vendim nr. 1068/22, dt.21.11.2024, i Komisionit Disiplinor)*;
3) *Pëllumb Feneri*, në pozicionin *"Specialist i Sektorit Juridikik"*, *(vendim nr. 1068/28, dt.21.11.2024, i Komisionit Disiplinor)*;
4) *Dorjana Spaho*, në pozicionin *"Specialist i Sektorit Juridik"*, *(vendim nr. 1068/21, dt.21.11.2024, i Komisionit Disiplinor)*;
5) *Kreshnik Ymeraj*, në pozicionin *"Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile"*, *(vendim nr. 1068/19, dt. 21.11.2024 i Komisionit Disiplinor)*;
6) *Rovena Nalbani*, në pozicionin *"Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Urban"*, *(vendim nr. 1068/23, dt. 21.11.2024, i Komisionit Disiplinor).*

Sa më sipër, Komisioni Disiplinor **ka realizuar** tërësinë e procedurave të përcaktuara në pikat nga 13 deri 20 të VKM nr. 115, dt. 5.3.2014, i ndryshuar.

### *III.11 Prefekti i Qarkut Korçë,*
*(në varësi të Ministrisë së Brendshme)*

Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se, për **11** nëpunës të Prefektit të Qarkut Korçë, institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka propozuar/rekomanduar masë disiplinore për *"shkelje të rëndë"*.

Organi disiplinor, në këtë rast Komisioni Disiplinor, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkeljes së pretenduar, ka vendosur ndërprerjen e ecurisë disiplinore për **10** nëpunësit, *(ndërsa për* ***1*** *nëpunës, nuk është vepruar pasi është liruar nga shërbimi civil për arsye se ka plotësuar moshën për pensionin),* për punonjësit:

- *Ornela Bena*, në pozicionin *"Sekretar i Përgjithshëm"*, *(vendimi nr. 1, dt. 20.11.2024, i Komisionit Disiplinor);*
- *Dorjan Kaçori*, në pozicionin *"Përgjegjës Sektori"*, *(vendimi nr. 2, dt. 20.11.2024, i Komisionit Disiplinor);*
- *Alda Sotiri*, në pozicionin *"Specialist"*, *(vendimi nr. 3, dt. 20.11.2024, i Komisionit Disiplinor);*
- *Suada Mjerashaj*, në pozicionin *"Specialist"*, *(vendimi nr. 4, dt. 20.11.2024, i Komisionit Disiplinor);*
- *Ledia Bonja*, në pozicionin *"Përgjegjës Sektori"*, *(vendimi nr. 5, dt. 20.11.2024, i Komisionit Disiplinor);*

- *Fjoralba Rëmbeci*, në pozicionin *"Specialist", (vendimi nr. 6, dt. 20.11.2024, i Komisionit Disiplinor);*
- *Margena Zonja*, në pozicionin *"Specialist", (vendimi nr. 7, dt. 20.11.2024, i Komisionit Disiplinor);*
- *Zarif Biba*, në pozicionin *"Përgjegjës Sektori", (vendimi nr. 8, dt. 20.11.2024, i Komisionit Disiplinor);*
- *Albert Xhafa*, në pozicionin *"Specialist", (vendimi nr. 9, dt. 20.11.2024 i Komisionit Disiplinor);*
- *Leonidh Muço*, në pozicionin *"Specialist", (vendimi nr. 10, dt. 20.11.2024 i Komisionit Disiplinor).*

Sa më sipër, Komisioni Disiplinor **ka realizuar** tërësinë e procedurave të përcaktuara në pikat nga 13 deri 20 të VKM nr. 115, dt. 5.3.2014, i ndryshuar.

### *III.12 Prefekti i Qarkut Shkodër,*
*(në varësi të Ministrisë së Brendshme)*

Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se, për **2** nëpunës të Prefektit të Qarkut Shkodër, institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka propozuar/rekomanduar masë disiplinore për *"shkelje të lehtë"*.

Eprori dirket i nëpunësit të cilit i atribuohet shkelja disiplinore e pretenduar, ka realizuar tërësinë e procedurave të përcaktuara në pikat nga 11 deri në 20, të VKM nr. 115, dt. 5.3.2014, i ndryshuar, dhe në përfundim ka vendosur të përmbyllë ecurinë disiplinore, pa dhënë masë disiplinore.

Më konkretisht:

- Për nëpunësin *Felek Kasemi*, Sekretar i Përgjithshëm në institucionin Prefekti i Qarkut Shkodër, me vendimin nr. 1, dt. 28.10.2024, të eprorit direkt, është përmbyllur ecuria disiplinore, pa dhënë masë disiplinore.

- Për nëpunësen *Hermina Albunesa*, Përgjegjëse në Sektorin Juridik, në institucionin Prefekti i Qarkut Shkodër, me vendimin 2, dt. 28.10.2024, të eprorit direkt është përmbyllur ecuria disiplinore, pa dhënë masë disiplinore.

Sa më sipër, eprori direkt **ka realizuar** tërësinë e procedurave të përcaktuara në pikat 11 deri 20 të VKM nr. 115, dt. 5.3.2014, i ndryshuar.

## IV. Disa statistika në lidhje me kërkesat për shkelje disiplinore të depozituara, numrin e shkeljeve të shqyrtuara si dhe llojin e masës së dhënë nga organi disiplinor.

| I | | | II | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkelje të rekomandura nga organe/njësi me kompetenca kontrolli të brendshëm apo të jashtëm. | | | Vendimi përfundimtar i organit disiplinor *(Lloji i masës së dhënë)* | | | |
| Shkelje shumë të rënda | Shkelje të rënda | Shkeleje të lehta | Marrje mase disiplinore për shkak të shkeljeve shumë të rënda të disiplinës | Marrje mase disiplinore për shkak të shkeljeve të rënda të disiplinës | Marrje mase disiplinore për shkak të shkeljeve të lehta të disiplinës | Ndërprerje të ecurisë disiplinore |
| 7 | 30 | 30 | 7 raste | 9 raste | 0 raste | 35 raste |
| **67 shkelje gjithsej të rekomanduara** | | | **51 rekomandime të shqyrtuara me vendim** | | | |

★ Numri i rekomandimeve të shqyrtuara me vendim përfundimtar të organit disiplinor është më i vogël se numri i përgjithshëm i shkeljeve të rekomandurara për arsye se në **15** raste, në zbatim të gabuar të ligjit, organi disiplinor ka vlerësuar paraprakisht *"Mosfillim të ecurisë disiplinore"* dhe në **1** rast, realizimi i ecurisë disiplinore është në proces. Këto raste janë analizuar në pikat përkatëse të këtij materiali.

*Grafiku nr.4: Situata në lidhje me kërkesat e administruara dhe të shqyrtuara nga organi disiplinor.*




- Kërkesa të shqyrtuara me vendim përfundimtar
- Kërkesa për mbyllura me mosfillim ecurie disiplinore
- Kërkesa të pashqyrtuara nga organi disiplinor

*Grafiku nr.5: Situata në lidhje me llojin e masës së dhënë nga organi disiplinor*




- Vendime për marrje mase shumë të rënde
- Vendime për marrje mase të rënde
- Vendime për ndërprerje te ecurisë disiplinore

## V. Konkluzione:

Nga sa është analizuar më sipër Komisioneri vlerëson se të gjitha institucionet të cilat janë në fushën e veprimit të ligjit 152/2013, në të gjitha rastet e përcaktuara qartësisht në Vendimin nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil"*, ndryshuar me vendimin nr. 437, datë 18.7.2018, të Këshillit të Ministrave si dhe Udhëzimi nr. 01 *(500 prot.)*, datë 21.1.2025, i Departamentit të Administratës Publike, *"Mbi organet disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore"*, duhet të respektojnë procedurat në përmbushje të detyrimeve ligjore, në rastet kur subject I kërkesave/rekomandimeve janë organet e parashikuara në piken 4 të gërma b, të nenit 59 të ligjit në fjalë.

Një vëmëndje e shtuar duhet të tregohet në rastet e parashikuara në VKM-në nr. 115, datë 5.3.2014, Kreu II, "*Procedura disiplinore*", pika 6/1:*" Përjashtimisht, për rastet kur shkeljet disiplinore të pretenduara janë konstatuar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, si dhe Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion, kërkesa/rekomandimi i depozituar në institucion, sipas pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi, i dërgohet komisionit disiplinor"*. Këto raste që përfshihen në këtë pikë të këtij akti nënligjor, duhet të ndiqen nga organi disiplinor i përcaktuar, duke kryer të gjithë procedurat përkatëse me qëllim përmbushjen e kërkesave ligjore.

Bazuar në përcaktimet e akteve rregullative të cituara si më sipër, në rastin e shkeljeve disiplinore të kërkuara/rekomandura nga organe me kompetenca kontrolli të jashtme ose të brendshme, organi disiplinor fillon menjëherë ecurinë disiplinore dhe më tej zbaton tërësinë e procedurave administrative disiplionore të parashikuara nga pika 13 deri në 20 të VKM nr. 115, datë 5.3.2014, i ndryshuar.
Nga sa analizohet në raportin e vlerësimit, Komisioneri çmon se të gjitha institucionet e administratës shtetërore të përmenduara në këtë material, që janë evidentuar me probleme në zbatimin e ligjit, nëpërmjet organeve të tyre të disiplinës, duhet të kryejnë të gjitha veprimet administrative në përmbushje të detyrave specifike gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, dhe më pas të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm të ministrisë përkatëse, si edhe Departamentin e Administratës Publike, si organi me cilësinë e njësisë përgjegjëse.

Në përfundim të këtyre procedurave nga organet e disiplinës, njësia e administrimit të burimeve njerëzore duhet të informojnë Komisionerin për masat e marra, brenda **30** ditëve nga marrja dijeni për këtë akt.

Procesi i mbikëqyrjes orientuese me këtë objekt do të vijojë më tej edhe përgjatë vitit 2026, prandaj të merren masa nga njësia e burimeve njerëzore për të organizuar statistikat përkatëse të cilat do të raportohen në mënyrë periodike pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, sipas një metodologjie që do të përcaktohet në vijim, e cila do ti njoftohet institucioneve.

Institucionet, të marrin masa për të ngritur Komisionin e Disiplinës, i cili është një organizëm i përhershëm, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, që përfshin të paktën një përfaqësues të njësisë së burimeve njerëzore të institucioonit dhe një përfaqësues të DAP-it, për institucionet e administratës shtetërore.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**

**Tabela 1:** Kerkesa per shkelje disiplinore të rekomanduara nga institucione me kompetenca kontrolli te brendshem apo te jashtem gjate vitit 2024. (*Mbikëqyrje e realizuar në zbatim të urdhrit nr. 110 (840 prot.), dt. 12.10.2024*).

| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Institucioni** | **Emri Mbiemri i nëpunësit civil** | **Pozicioni i punës sipas kategorisë në shërbimin civil** | **Organi administrative që ka propozuar masën disiplinore** | **Organit disiplinor drejtuar kërkesa (Eprori direct, KD, KKP)** | **Lloji i shkeljes së konstatuar** | **Lloji i masës së aplikuar** | **Vendimi përfundimtar** | **A është ankimuar vendimi në gjykatë** | **Statusi aktual në rastet e ankimuara në gjykatë** | **Shënime** |
| **1. KRYEMINISTRIA DHE INSTITUCIONET E VARËSISË** | | | | | | | | | | | |
| 1.1 | Kryeministria | Hektor Dodbiba | Koordinator në Drejtorinë e Koordinimit Ndërinstitucional dhe Kapaciteteve, në Njësinë për Integrimin Evropian, në Departamentin e Politikës dh Integrimit Evropian (III-1) | Eprori Direkt | KD | Shumë e rëndë | Largim nga Shërbimi civil | Vendim KD nr.1, datë 23.2.2024 | - | - | - |
| 1.2 | Drejtoria Pergjithshme e Arkivave | Armir Hoxha | Specialist (arkivist), kategoria IV-a | Eprori direkt | KD | E rëndë | Mbajtje page 1/3 për 6-muaj | Nr.1, datë 04.03.2024 | - | - | Aktualisht nëpunës i larguar |
| 1.3 | Drejtoria Pergjithshme e Arkivave | Arben Dervishllari | Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse | Eprori direkt | Eprori direkt | E lehtë | Vërejtje | Nr. 2, 05.07.2024 | - | - | - |
| **2. MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT** | | | | | | | | | | | |
| 2.1 | Ministria e Arsimit dhe Sporti | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 2.2 | Agjenica Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 2.3 | Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 2.4 | Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| **3. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL** | | | | | | | | | | | |
| 3.1 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.2 | Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.3 | Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqesor Shkoder | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.4 | Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqesor Lushnje | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.5 | Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqesor Tirane | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.6 | Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqesor Korçë | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.7 | Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujqesore Fushe-Kruje | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.8 | Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujqesore Lushnje | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.9 | Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujqesore Vlore | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.10 | Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujqesore Korce | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.11 | Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujqesore Shkoder | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.12 | Autoriteti Kombetar i Veterinarise dhe Mbrojtjes se Bimeve | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.13 | Drejtoria Rajonale e Veterinarise dhe Mbrojtjes se Bimeve Tirane | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.14 | Drejtoria Rajonale e Veterinarise dhe Mbrojtjes se Bimeve Shkoder | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.15 | Drejtoria Rajonale e Veterinarise dhe Mbrojtjes se Bimeve Elbasan | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.16 | Drejtoria Rajonale e Veterinarise dhe Mbrojtjes se Bimeve Vlore | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.17 | Enti Shteteror i Farave dhe Fidaneve | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.18 | Agjencia Kombetare e Duhan Cigareve | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.19 | Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3.20 | Drejtoria e Sherbimeve te Peshkimit dhe Akuakulturës | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| **4. MINISTRIA E DREJTËSISË** | | | | | | | | | | | |
| 4.1 | Instituti i Mjeksisë Ligjore | Silvana Coka | Specialist (Juriste) | Eprori direkt | KD | Shumë e rëndë | argim nga shërbimi Ci | Nr.4 datë 13.09.2024 | po | - | - |
| 4.2 | Instituti Mjeksisë Ligjore | Silvana Çoka | Specialist (Juriste) | Eprori Direkt | Eprori Direkt | E lehtë | Vërejtje | Nr. 4325/4 datë 27.05.2024 | - | - | - |
| **5. MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË** | | | | | | | | | | | |
| 5.1 | Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera | Entela Xhakollari | Kategori e Mesme Drejtuese | Eprori Direkt | KD | E rëndë | Pezullimin nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pages për një periudhë deri në dy vjet | 99/19 prot, date 31.01.2025 | Në pritje të ankimit | Në pritje të ankimit | - |
| **6. MINISTRIA E FINANCAVE** | | | | | | | | | | | |
| 6.1 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Dalina Teferiçi | Drejtor Rajonal | DIBA-Drejtoria e investigimit të brendshëm antikorrupsion në DPT | KD | E rëndë | Mbajtje 1/3 e pagës për një periudhë 6-mujore | Vendim Nr. 47, dt. 07.02.2024 | - | - | Gjykimi ka përfunduar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë. Në pritje të arsyetimit dhe njoftimit të vendimit nga Gjykata. |
| 6.2 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Dritan Xhija | Përgjegjës Sektori | DIBA-Drejtoria e investigimit të brendshëm antikorrupsion në DPT | KD | E rëndë | Largim nga shërbimi civil | Vendim Nr. 48, dt. 07.02.2024 | - | - | Në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë |
| 6.3 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Dorjan Deçolli | Inspektor i Kontrolli | DIBA-Drejtoria e investigimit të brendshëm antikorrupsion në DPT | KD | E rëndë | Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1-vjeçare | Vendim Nr. 49, dt. 07.02.2024 | | | Në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë |
| 6.4 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Apostol Duka | Inspektor i Kontrolli | DIBA-Drejtoria e investigimit të brendshëm antikorrupsion në DPT | KD | E rëndë | Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1-vjeçare | Vendim Nr. 50, dt. 07.02.2024 | - | - | Në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë |
| 6.5 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Gjergji Duro | Përgjegjës Sektori | Kontrolli i Lartë i shtetit+DKT+Drejtoria e investigimit të brendshëm antikorrupsion në DPT | KD | shkelje shumë e rëndë | Largim nga shërbimi civil | Vendim Nr. 129, dt. 13.03.2024 | - | - | Në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë |
| 6.6 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Dritan Milori | Përgjegjës Sektori | DIBA-Drejtoria e investigimit të brendshëm antikorrupsion në DPT | KD | shkelje shumë e rëndë | Largim nga shërbimi civil | Vendim Nr. 231,dt. 23.05.2024 | - | - | Në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë |
| 6.7 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Ervis Kapo | Inspektor i Dytë Borxhi | DIBA-Drejtoria e investigimit të brendshëm antikorrupsion në DPT | KD | shkelje shumë e rëndë | Largim nga shërbimi civil | Vendim nr. 230, dt. 23.05.2024 | - | - | Në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë |
| 6.8 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Mario Zyla | Inspektor i Dytë Borxhi | DIBA-Drejtoria e investigimit të brendshëm antikorrupsion në DPT | KD | shkelje shumë e rëndë | Largim nga shërbimi civil | Vendim Nr. 229, dt. 23.05.2024 | - | - | Në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë |
| 6.9 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Eris Rezhda | Inspektor i Dytë Borxhi | DIBA-Drejtoria e investigimit të brendshëm antikorrupsion në DPT | KD | shkelje shumë e rëndë | Largim nga shërbimi civil | Vendim Nr. 228, dt. 23.05.2024 | - | - | Nuk rezulton e njoftuar kërkesë padi pranë DPT-së. |
| 6.10 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Altin Haxhi | Inspektor i Parë Kontrolli | DKT -Drejtoria e kontrollit tatimor në DPT | KD | shkelje shumë e rëndë | Largim nga shërbimi civil | Vendim Nr. 159, dt. 04.04.2024 | - | - | Në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.11 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Aurel Cenolli | Drejtor Drejtorie | Eprori Direkt+DVKT Rajoni Qendror | KD | shkelje shumë e rëndë | Largim nga shërbimi civil | Vendim Nr. 178, dt. 22.04.2024 | Po | Ne proces | Ne proces në Gjykatën Administrative të Apelit. |
| 6.12 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Xhevahir Toçilla | Përgjegjës Sektori | DIBA-Drejtoria e investigimit të brendshëm antikorrupsion në DPT | KD | E rëndë | Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 mujore. | Vendim Nr. 341,dt. 22.08.2024 | - | - | Nuk rezulton e njoftuar kërkesë padi pranë DPT-së. |
| 6.13 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Elmira Elmazaj | Përgjegjës Sektori | Kontrolli i Lartë i shtetit | KD | E rëndë | Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë | Vendim Nr. 430, dt. 04.11.2024 | - | - | Nuk rezulton e njoftuar kërkesë padi pranë DPT-së. |
| 6.14 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Artan Pasholli | Drejtor Rajonal | KLSH-Kontrolli i Lartë i shtetit | KD | shkelje shumë e rëndë | Largim nga shërbimi civil | Vendim Nr. 417, dt. 29.10.2024 | - | - | Nuk rezulton e njoftuar kërkesë padi pranë DPT-së. |
| **7. MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT** | | | | | | | | | | | |
